

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR
“PUNIME DURALUMINI”

Kodi: PK-F-3-20

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME DURALUMINI”

(PK-F-3-20)

I. Profili profesional i punëtorit të punimeve duralumini.

a) Karakteristikat e punëtorit të punimeve duralumini

Punëtori i punimeve duralumini është i aftë të kryejë *detyra profesionale*, si i punësuar në ndërmarrje/reparte të punimeve mekanike për prodhime duralumini, mund të vetëpunësohen, ose mund të hapin një biznes të vogël për prodhime duralumini.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori i punimeve duralumini duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të duraluminit.

Suksesi i punëtorit të punimeve duralumini është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punëtorit të punimeve duralumini

Profesioni i punëtorit të punimeve duralumini është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e punimeve mekanike për prodhime duralumini. Ai mund të punësohet ose vetëpunësohet në ndërmarrje/reparte dhe biznese që kryejnë veprimtari, në sektorin e prodhimeve të duraluminit.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punëtorit të punimeve duralumini të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një punëtor për punimeve duralumini mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punimeve duralumini”

Në përfundim të kursit për punime duralumini, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për punime të duraluminit.
- Realizojnë organizimin e vendit të punës për punime të duraluminit.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit të punës gjatë punimeve të duraluminit.
- Përzgjedhin drejt dhe përdorin në mënyre korrekte veglat, pajisjet dhe instrumentat e punës për punime duralumini.
- Përzgjedhin materialet dhe aksesoret e duhura për punimet dhe prodhimet e duraluminit.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.
- Interpretojnë vizatime teknike dhe përgatisin skica të thjeshta të prodhimeve të duraluminit.
- Realizojnë matje dhe kontrole mekanike me përdorimin e instrumentave përkatëse.
- Realizojnë punimet bazë të axhusterisë për prodhime duralumini, me vegla dore, me vegla elektrike dore dhe me makina.
- Prodhojnë dhe montojnë dyer njëkanatëshe prej duralumini.

- Prodhojnë dhe montojnë dritare prej duralumini me shinë.
- Prodhojnë dhe montojnë grila prej duralumini.
- Prodhojnë dhe montojnë parmakë të shkallëve duralumini.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e duraluminit.
- Zbatojnë standardet e profesionit.
- Komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Punime duralumini”.

Pjesmarrësit në Kursin “Punime duralumini” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Punime duralumini”

360 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Punime duralumini”

Nr	Titulli i Modullit	Kod i	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në veprimtarinë e punëtorit të punimeve të duraluminit	MK-04-204-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori 30% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e veprimtarisë të punëtorit të punimeve duralumini. 2. Kursanti përshkruan prodhimet kryesore të duraluminit. 3. Kursanti interpreton vizatime dhe përgatit skica të thjeshta për prodhimet e duraluminit. 4. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentet në punimet e duraluminit. 5. Kursanti përshkruan materialet dhe aksesoret kryesore në punimet e duraluminit. 6. Kursanti kryen matje, shënime dhe kontrolle për punime të duraluminit. 7. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në punimet e duraluminit.
2	Proceset bazë të punimit të duraluminit	MK-04-205-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti realizon procese punimi duralumini me vegla dhe pajisje dore. 2. Kursanti realizon procese punimi duralumini me vegla dore elektrike. 3. Kursanti realizon procese punimi duralumini me makineri.

3	Prodhimi dhe montimi i derës njëkanatëshe duralumini.	MK-04-206-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit prodhimin dhe montimin e derës njëkanatëshe duralumini. 2. Kursanti prodhon kasën e derës njëkanatëshe duralumini. 3. Kursanti prodhon kanatin e derës duralumini. 4. Kursanti monton në objekt derën njëkanatëshe duralumini.
4	Prodhimi dhe montimi i dritares duralumini me shinë.	MK-04-207-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit prodhimin dhe montimin e dritares prej duralumini me shinë (rrëshqitje). 2. Kursanti prodhon kasën e dritares prej duralumini me shinë. 3. Kursanti prodhon kanatat e dritares prej duralumini me shinë. 4. Kursanti monton në objekt dritaren prej duralumini me shinë.
5	Prodhimi dhe montimi i grilës prej duralumini	MK-04-208-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit prodhimin dhe montimin e grilës prej duralumini. 2. Kursanti prodhon grilën prej duralumini (tip kasete). 3. Kursanti monton në objekt grilën prej duralumini.
6	Prodhimi dhe montimi i grilave tip Persiane duralumini	MK-04-209-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit prodhimin dhe montimin e grilës prej duralumini. 2. Kursanti prodhon grilën prej duralumini (tip kasete). 3. Kursanti monton në objekt grilën prej duralumini.
7	Prodhimi dhe montimi i parmakëve të shkallëve duralumini	MK-04-210-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit prodhimin dhe montimin e parmakëve të shkallëve duralumini. 2. Kursanti realizon punime të prerjes për përgatitjen e parmakëve të shkallëve prej duralumini 3. Kursanti realizon punime të shpimit për përgatitjen e parmakëve të shkallëve prej duralumini. 4. Kursanti monton parmakët e shkallëve prej duralumini. 5. Kursanti monton në objekt parmakët e shkallëve prej duralumini.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik. Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Punime duralumini”:

1. Moduli “Hyrje në veprimtarinë e punëtorit të punimeve duralumini”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË VEPRIMTARINË E PUNËTORIT TË PUNIMEVE DURALUMINI	MK-04-204-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veprimtarinë e punëtorit të punimeve duralumini, me mjedisin, prodhimet, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së punuesit të duraluminit, me veçoritë dhe kërkesat e këtij profesioni dhe me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, i aftëson ata për të interpretuar vizatime dhe përgatitur skica të thjeshta të punimeve të duraluminit, të kryejnë matje dhe shënime si dhe të përdorin mjetet e mbrojtjes në punë e ato të dhënies së ndihmës së parë.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e veprimtarisë së punëtorit të punimeve duralumini. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë legjislacionin në fuqi dhe kodin e punës.- të përshkruajë kërkesat profesionale të punëtorit për punimet duralumini.- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punëtorit të punimeve duralumini.- të tregojë mundësitë e punësimit të punëtorit për punimet duralumini.- të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të punëtorit duralumini.- të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët.- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës në punimet duralumini.- të përshkruajë rëndësinë e organizmit të punës, strukturën organizative dhe komunikimin hierarkik.- të tregojë cilat janë mundësitë e punësimit të punuesit të duraluminit.- të përshkruajë mënyrën se si bëhen llogaritje të thjeshta të punimeve duralumini (kostot dhe volumi i punës, sasia e materialeve, veglave dhe pajisjeve të punës, çmimi i punimeve etj.).	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan prodhimet kryesore të duraluminit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë klasifikimin dhe përdorimin e përgjithshëm të prodhimeve duralumini.
- të përshkruajë veçoritë konstruktive dhe përdorimet e prodhimeve kryesore prej duralumini.
- të përshkruajë llojet kryesore, veçoritë konstruktive dhe përdorimet e dyerve prej duralumini.
- të përshkruajë llojet kryesore, veçoritë konstruktive dhe përdorimet e dritareve prej duralumini.
- të përshkruajë llojet kryesore, veçoritë konstruktive dhe përdorimet e vetratave prej duralumini.
- të përshkruajë llojet kryesore, veçoritë konstruktive dhe përdorimet e grilave prej duralumini.
- të përshkruajë llojet kryesore, veçoritë konstruktive dhe përdorimet e parrakëve prej duralumini.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan vendin, veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentet në punimet e duraluminit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë skemën e organizimit të një reparti për punime duralumini.
- të përshkruajë klasifikimin e veglave, pajisjeve, makinave dhe instrumentave në punimet e duraluminit.
- të përshkruajë veshjen e punës së punuesit të duraluminit.
- të listojë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për prerjen e elementeve të duraluminit, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të listojë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për shpimin në punimet e duraluminit, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të listojë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për frezime në elementet e duraluminit, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të listojë veglat dhe pajisjet për axhustime në punimet e duraluminit, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të listojë veglat dhe pajisjet për montime në punimet e duraluminit, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve, makinave dhe instrumentave për punime të duraluminit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti përshkruan materialet dhe aksesorët kryesore në punimet e duraluminit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë klasifikimin e përgjithshëm të materialeve në punimet e duraluminit.
- të përshkruajë aksesorët e përgjithshëm në punimet e duraluminit.
- të listojë profilet e duraluminit.
- të përshkruajë llojet, karakteristikat, markat dhe përdorimet e duraluminit.
- të listojë aksesorët për prodhimet duraluminit.
- të përshkruajë llojet, karakteristikat dhe markat e aksesorëve në punimet e duraluminit.
- të listojë materialet ndihmëse për punimet e duraluminit.
- të përshkruajë llojet dhe karakteristikat dhe përdorimet e materialeve ndihmëse në punimet e duraluminit.
- të zbatojë rregullat për magazinimin, ruajtjen dhe sistemimin e materialeve për punimet e duraluminit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti interpreton vizatime dhe përgatit skica të thjeshta për prodhimet e duraluminit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rregullat për vizatimet e punës së prodhimeve të duraluminit.
- të interpretojë simbolet që përdoren në vizatimet e punës së prodhimeve të duraluminit.
- të përshkruajë paraqitjen e përmasave në vizatimet e punës së prodhimeve të duraluminit.
- të përshkruajë shënimet teknike në vizatimet e punës së prodhimeve të duraluminit.
- të përshkruajë rregullat për përgatitjen e skicave të punës së prodhimeve të duraluminit.
- të interpretojë simbolet që përdoren në skicat e punës së prodhimeve të duraluminit.
- të realizojë zberthimin e përmasave në skicat e punës së prodhimeve të duraluminit.
- të përgatitë skica të thjeshta të punës së prodhimeve të duraluminit.
- të përshkruajë mjetet e nevojshme për përgatitjen e skicave të punës së prodhimeve të duraluminit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 6 Kursanti kryen matje dhe shënime për punime për punime të duraluminit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë matjen, kuptimin e matjeve.
- të përshkruajë instrumentat matëse dhe përdorimin e tyre
- të realizojë matjet me metër shirit.
- të përshkruajë ndërtimin e instrumentit matës të këndeve (goniometri).
- të realizojë matje të këndeve me këndmatës.
- të realizojë procedurat për matjen e përmasave.
- të realizojë vijëzime dhe shënime me instrumentet përkatëse.
- të realizojë shënime me ndihmën e këndorit dhe prizmës.
- të realizojë shënime me shabllon.
- të realizojë procedurat e kontrollit të horizontalitetit dhe vertikalitetit.
- të realizojë llogaritjen e shumës së gjatësive të profileve për prodhime të duraluminit.
- të përshkruajë kujdesin për instrumentet dhe mjetet shënuese, matëse dhe kontrolluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me shkrim dhe gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 7 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në punimet e duraluminit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të ruajtjes së personit në punë gjatë punimeve në punimet duralumini.
- të përshkruajë burimet e rreziqeve në objekte;
- të përshkruajë procedurat dhe protokollet standarde të sigurisë sipas rastit të emergjencës (tërmet, përmblytje, etj.);
- të përshkruajë masat e mbrojtjes në vendin ku kryhen punimet duralumini.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga rryma elektrike.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zjarri.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zhurmat.
- të shpjegojë masat e ruajtjes së mjedisit.
- të përdorë dhe mirëmbajë kompletin e veshjes së punës (rrobot, këpucët, përparësja e lëkurës, dorezat, maska, syzet, mbrojtësja e zhurmave, litari dhe rrypi special).
- të përdorë dhe mirëmbajë siguresat, tokëzimet, shtrojet e gomës për dysheme për mbrojtjen nga rryma elektrike.
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet për shuarjen e zjarrit.
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet e ventilimit dhe ajrosjes punimet në makinat metalprerëse.
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet sinjalizuese të rrezikut.
- të mirëmbajë mjedisin e punës gjatë punimeve duraluminit.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes gjatë përdorimit të mjeteve të mbrojtjes në punë.
- të shpjegojë rëndësinë dhe përmbajtjen e kutisë së ndihmës së parë.
- të përdorë drejt mjetet dhe medikamentet e ndihmës së parë.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e djegieve.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e plagosjeve.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e humbjes së vetëdijes.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e goditjes nga rryma elektrike.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve të duraluminit. Mund të organizohen dhe vizita dhe praktika në në reparte punimesh duralumini të bizneseve lokale.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet dhe demonstrimet konkrete për kushtet, mjediset, pajisjet, veglat dhe materialet e punës në repartin e punimeve të duraluminit, për matjet dhe kontrollet, për vizatimet dhe skicat e prodhimeve duralumini, si dhe për masat e sigurisë dhe dhënien e ndihmës së parë.
- Kursantët duhet të demonstrojnë kryerjen e matjeve, shënimeve dhe kontrolleve, interpretimin e vizatimeve, bërjen e skicave, marrjen e masave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit, si dhe të angazhohen në diskutime në lidhje me mjedisin, kushtet dhe kërkesat gjatë realizimit të punimeve të duraluminit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet tu kërkohet atyre që të përshkruajnë konkretisht mjedisin, pajisjet, veglat, materialet, kushtet e kërkesat e profesionit të punuesit të duraluminit, si dhe të demonstrojnë, matjet e kontrollet, bërjen e skicave, marrjen e masave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Repart i punimeve të duraluminit.
 - Komplet i veglave të punuesit të duraluminit.
 - Instrumente matëse dhe kontrolluese.
-

-
- Makinat dhe instrumentet e punës në repartin e punimeve të duraluminit.
 - Materialet e punës dhe materialet ndihmëse për punime duraluminit.
 - Kutia e ndihmës së parë.
 - Vizatime dhe skica pune të prodhimeve duralumini.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

2. Moduli “Proceset bazë të punimit të duraluminit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PROCESET BAZË TË PUNIMIT TË DURALUMINIT	MK-04-205-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me llojet dhe veçoritë e proceseve bazë të punimeve të duraluminit, si dhe i aftëson ata për të kryer këto procese pune me vegla dore, me vegla dore elektrike dhe me makina.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përmbushur modulën “Hyrtje në veprimtarinë e punëtorit të punimeve të duraluminit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen procese punimi duralumini me vegla dhe pajisje dore. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë skicën ose vizatimin e konstruksionit me profile duralumini.- të përzgjedhë profilet e duhura të duraluminit.- të përshkruajë llojet e punimeve me vegla dore dhe përdorimet e tyre në punimet e duraluminit.- të përshkruajë llojet e veglave të dorës për punime duralumini dhe përdorimi i tyre.- të realizojë matje dhe shënime të sakta në profilet e duraluminit.- të vendosë dhe të shtrëngoje si duhet profile të duraluminit në pajisjen shtrënguese.- të zbatojë teknikat e duhura të sharrimit të profileve me sharrë dore.- të zbatojë teknikat e duhura të axhustimit me lima për punime duralumini.- të zbatojë teknikat e duhura të prerjes me gërshërë të gominave dhe qelesheve.- të zbatojë teknikat e duhura të gdhëndjes së mureve me daltë, për montime të prodhimeve të duraluminit në objekt.- të zbatojë teknikat e duhura të shpimit të foleve në profilet e duraluminit, me anë të stampës së dorës.- të zbatojë teknikat e duhura të montimeve me vida, me përdorimin e kaçavidave dhe çelësave hegzagonal.- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punimit të duraluminit me vegla dore. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.	

-
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen procese punimi duralumini me vegla dore elektrike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë skicën ose vizatimin e konstruksionit me profile duralumini.
- të përzgjedhë profilet e duhura të duraluminit.
- të përshkruajë llojet e punimeve me vegla dore elektrike dhe përdorimet e tyre në punimet e duraluminit.
- të përshkruajë llojet e veglave elektrike të dorës dhe përdorimi i tyre punimet e duraluminit.
- të realizojë matje dhe shënime të sakta në profilet e duraluminit.
- të vendosë dhe të shtrëngojë si duhet profile të duraluminit në pajisjen shtrënguese.
- të zbatojë teknikat e duhura të axhustimeve dhe e prerjes së paneleve të duraluminit me gur fleksibël (troko) elektrik.
- të zbatojë teknikat e duhura të shpimeve të llojeve të ndryshme, me trapano elektrike dore.
- të zbatojë teknikat e duhura të shpimeve të llojeve të ndryshme, me matrapik elektrike dore.
- të zbatojë teknikat e duhura të frezimeve të llojeve të ndryshme, me frezë elektrike dore (ruter).
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat elektrike të dorës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të duraluminit me vegla elektrike dore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen procese punimi duralumini me makineri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë skicën ose vizatimin e konstruksionit me profile duralumini.
- të përzgjedhë profilet e duhura të duraluminit.
- të përshkruajë llojet e punimeve të duraluminit që kryhen me makina dhe instrumentat përkatëse.
- të tregojë ndërtimin dhe funksionimin e makinave kryesore të punimit të duraluminit.
- të tregojë vendosjen dhe heqjen e instrumenteve prerëse në makinat e punimit të duraluminit.
- të realizojë regjistrimin e parametrave të punës në makinat e punimit të duraluminit, kryerjen e punimeve të ndryshme.
- të realizojë procedurat e sharrimit të profileve të duraluminit në kënde të ndryshme, në makinën sharrë me disk.
- të realizojë procedurat e shpimit të profileve të duraluminit me trapano elektrike bangoje.

- të realizojë procedurat e frezimit të foleve të bravave në frezën elektrike.
- të realizojë procedurat e mprehjes së instrumenteve prerëse në gur zmeril bangoje.
- të realizojë procedurat e
- të tregojë kujdesin dhe mirëmbajtja e makinave për punime të duraluminit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të duraluminit me makina.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve të duraluminit. Mund të organizohen dhe vizita dhe praktika në reparte punimesh duralumini të bizneseve lokale.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve bazë të punimit të duraluminit, me vegla dore, me vegla elektrike dore dhe me makina.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike të sharrimit, shpimit, daltimit, axhustimit, frezimit, etj., me vegla dore, me vegla elektrike dore dhe me makina, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Repart i punimeve të duraluminit.
 - Komplet i veglave të dorës.
 - Komplet i veglave elektrike të dorës.
 - Komplet i makinave të punimit të duraluminit.
 - Instrumente prerëse.
 - Instrumente matëse dhe kontrolluese.
 - Materiale duralumini.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Prodhimi dhe montimi i derës njëkanatëshe duralumini”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI DHE MONTIMI I DERËS NJËKANATËSHE DURALUMINI	MK-04-206-20
Qëllimi i modullit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës për të prodhuar dhe montuar derë njëkanatëshe duralumini, si dhe i aftëson ata për të prodhuar dhe montuar në objekt këtë lloj dera, me përdorimin e veglave, pajisjeve dhe makinave të nevojshme.	
Kohëzgjatja e modullit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përmbushur modulet “Hyrtje në veprimtarinë e punëtorit të punimeve të duraluminit” dhe “Proceset bazë të punimit të duraluminit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit prodhimin dhe montimin e derës njëkanatëshe duralumini. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë llojet e dyerve prej duralumini, veçoritë konstruktive dhe përdorimet e tyre. - të përshkruajë materialet dhe aksesorët që përdoren për prodhimin e dyerve prej duralumini. - të përshkruajë procesin teknologjik për prodhimin e dyerve prej duralumini. - të përshkruajë kushtet dhe kërkesat teknike të dyerve prej duralumini. - të realizojë matje të saktë në objektin ku do të vendoset dera. - të realizojë vizatimin ose skicimin e derës njëkanatëshe duralumini. - të analizojë vizatimin teknik ose skicën e derës njëkanatëshe prej duralumini - të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesorëve të nevojshëm - të llogarisë në mënyrë të përafërt përbërësit e kostos dhe koston e plotë. - të llogarisë në mënyrë të përafërt çmimin, të ardhurat dhe fitimin - të përzgjedhë materialet dhe aksesorët e nevojshëm. - të përzgjedhë veglat, pajisjevet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e derës njëkanatëshe prej duralumini. - të realizojë organizimin e vendit të punës për prodhimin e derës njëkanatëshe prej duralumini. - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin dhe montimin e 	

derës njëkanatëshe prej duralumini..

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti prodhon kasën e derës njëkanatëshe duralumini.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të zbatojë procesin e duhur teknologjik të prodhimit të kasës së derës njëkanatëshe duralumini;
- të përgatisë veglat dhe makinat për punë.
- të realizojë matje dhe shënime të profilet të kasës.
- të realizojë procedurat e prerjes së profileve sipas masave të caktuara.
- të realizojë procedurat e prerjes së këndeve 45° të profilet e kasës.
- të realizojë procedurat e hapjes së vrimave të montimit me presë dore.
- të realizojë procedurat e futjes në kanalet e profileve dhe prerjes së gominave.
- të realizojë procedurat e montimit me aksesore të elementeve të kasës, në bango.
- të realizojë procedurat e vendosjes së menteshave të kasës së derës.
- të realizojë sistemimin e kasës së derës.
- të realizojë matje dhe shënime të nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kasës së derës njëkanatëshe duralumini.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti prodhon kanatin e derës duralumini.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të zbatojë procesin e duhur teknologjik të prodhimit të kanatit të derës duralumini.
- të përgatisë veglat dhe makinat për punë.
- të realizojë matje dhe shënime të profilet e kanatit.
- të realizojë procedurat e prerjes së profileve sipas masave të caktuara.
- të realizojë procedurat e prerjes së këndeve 45° të profilet e kanatit.
- të realizojë procedurat e hapjes së vrimave të montimit me presë dore.
- të realizojë procedurat e futjes në kanalet e profileve dhe prerjes së gominave.
- të realizojë procedurat e hapjes së vrimave të fundorit me anë të presës së dorës.
- të realizojë vendosjen dhe prerjen e gominave dhe furçave

- në fundor.
- të realizojë procedurat e montimit me aksesori i elementeve të kanatit, në bango.
- të realizojë procedurat e vendosjes së menteshave të kanatit të derës.
- të realizojë hapjen e folesë së bravës në kanatin e derës.
- të realizojë procedurat e montimit të bravës në kanatin e derës.
- të llogarisë përmasat përfundimtare të xhamit të derës.
- të realizojë matjen dhe prerjen e gominave të xhamit të derës.
- të realizojë matjen dhe prerjen e pikaqeve (mbajtëseve) të xhamit të derës.
- të realizojë matje dhe shënime të nevojshme.
- të realizojë sistemimin e kanatit të derës duralumini.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kanatit të derës duralumini.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti monton në objekt derën njëkanatëshe

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të parapërgatisë objektin për montimin e derës njëkanatëshe duralumini.
- të zbatojë procesin e duhur teknologjik të montimit në objekt të derës njëkanatëshe duralumini.
- të përgatisë veglat dhe makinat për montimin e derës njëkanatëshe duralumini.
- të realizojë transportimin e derës dhe veglave e pajisjeve në objekt.
- të realizojë matjet dhe kontrollet në objekt.
- të realizojë vendosjen paraprake të kasës në objekt dhe kryerjen e rregullimeve të nevojshme.
- të realizojë vendosjen e kasës dhe nivelimi për montim në objekt.
- të realizojë montimin e kasës me vida në objekt.
- të realizojë procedurat e vendosjes së kanatit në kasë.
- të realizojë procedurat e regjistrimit të menteshave të derës.
- të realizojë shënimin dhe hapjen e folesë së bravës në kasë.
- të realizojë montimin e kundrabravës.
- të realizojë heqjen e pikaqeve dhe vendosja e xhamit.
- të realizojë vendosjen e pikaqeve dhe gominave të xhamit.
- të realizojë kontrollin e nivelit dhe të funksionimit të derës.
- të realizojë mbushjet me silikon ose me shkumë.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit në objekt të derës njëkanatëshe duralumini.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimit të duraluminit ose në reparte punimi duralumini të bizneseve lokale.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës për prodhimin dhe montimin e derës njëkanatëshe duralumini, me vegla dore, me vegla elektrike dore dhe me makina.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike të matjes, punimit të elementeve të duraluminit, montimit të elementeve të derës njëkanatëshe duralumini dhe montimit të saj në objekt, me përdorimin e veglave të dorës, veglave elektrike të dorës dhe makinave, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Repart i punimeve të duraluminit dhe objekt për montime të dyerve të duraluminit.
 - Komplet i veglave të dorës.
 - Komplet i veglave elektrike të dorës.
 - Komplet i makinave të punimit të duraluminit.
 - Instrumente prerëse.
 - Instrumente matëse dhe kontrolluese.
 - Materiale duralumini dhe aksesore.
 - Vizatime ose skica të dyerve njëkanatëshe duralumini.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

4. Moduli “Prodhimi dhe montimi i dritares duralumini me shinë”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI DHE MONTIMI I DRITARES DURALUMINI ME SHINË	MK-04-207-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës për të prodhuar dhe montuar dritare duralumini me shinë, si dhe i aftëson ata për të prodhuar dhe montuar në objekt këtë lloj dritareje, me përdorimin e veglave, pajisjeve dhe makinave të nevojshme.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përbushur modulet “Hyrtje në veprimtarinë e punëtorit të punimeve të duraluminit” dhe “Proceset bazë të punimit të duraluminit”.	
